

## **Marrëveshja mbi Pjesëmarrjen e Kreditorëve në Skemën e Debitimit Direkt në Kosovë**

Për: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK)  
Drejtorati i Sistemeve të Pagesave Ndërbankare (SPN) në BQK

Nga: Pjesëmarrësi i propozuar – emërtimi i organizatës

-----  
(pjesëmarrësi i propozuar)

### **Preambula**

Skema e Debitimit Direkt është skema e vetme dhe unike e cila operon në Kosovë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – Drejtorati i Sistemeve të Pagesave Ndërbankare operon, kontrollon dhe administron operacionet e skemës në përputhje me udhëzimet dhe procedurat e operimit (“Udhëzimi”) të përcaktuara në Rregullën XXXI të Skemës së Debitimit Direkt në Kosovë (“Rregulla”).

Rregulla i përcakton të drejtat dhe obligimet e të gjitha institucioneve të cilat obligohen nga kushtet e saj (‘pjesëmarrësit’) dhe të SPN-së, dhe e obligon secilin pjesëmarrës t’i përmbahet obligimeve ndaj SPN-së dhe ndaj pjesëmarrësve të tjerë në pajtim me rregullat e përcaktuara këtu.

SPN-ja në emër të vetin dhe në emër të të gjithë pjesëmarrësve, do të njoftojë pjesëmarrësin e propozuar për datën pas datës së gatishmërisë (ashtu siç është përcaktuar më poshtë) në të cilën kjo marrëveshje për aderim bëhet e plotfuqishme (data e fillimit) në mes të pjesëmarrësit të ri, SPN-së dhe pjesëmarrësve të tjerë.

Nga data e fillimit pjesëmarrësi i propozuar bëhet pjesëmarrës dhe i nënshtrohet të gjitha obligimeve, detyrimeve, si dhe gëzon të gjitha të drejtat ashtu siç janë përcaktuar me Rregull.

### **ËSHTË ARRITUR KJO MARRËVESHJE:**

1. Pjesëmarrësi i propozuar merr përsipër dhe obligohet ndaj SPN-së dhe pjesëmarrësve të tjerë të përmbushë obligimet e vendosura dhe t’i përmbahet kushteve të Rregullës, ndryshimeve dhe plotësimeve të kohëpaskohshme, të aplikueshme që nga data e fillimit .
2. Pjesëmarrësi i propozuar deklaron dhe garanton si në vijim:
  - 2.1 Pjesëmarrësi i propozuar ka fuqinë dhe autoritetin të hyjë dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura për të autorizuar hyrjen e vet në skemë dhe të përmbushë obligimet dhe t’i përmbahet kushteve të Rregullës.
  - 2.2 Nënshkruesit e pjesëmarrësit të propozuar i kanë të gjitha autorizimet e duhura si dhe fuqinë dhe autoritetin për të lidhur dhe obliguar pjesëmarrësin e propozuar ndaj Rregullës.

2.3 Pjesëmarrësi i propozuar duhet të sigurojë që gjatë gjithë kohës së pjesëmarrjes në skemë do t'i plotësojë kriteret e pjesëmarrjes në skemë ashtu siç janë të përcaktuara në Rregull. Në rast se në çdo kohë pjesëmarrësi ka arsye të mendojë se nuk i plotëson këto kritere apo nuk është në gjendje të plotësojë këto kritere duhet të njoftojë SPN-në lidhur me rrethanat e krijuara.

2.4 Pjesëmarrësi i propozuar do të jetë në gjendje të përmbushë të gjitha obligimet e përcaktuara në Rregull nga.....(shëno datën).....(data e gatishmërisë)

3. Me dorëzimin e këtij formulari të plotësuar të Marrëveshjes për Aderim, pjesëmarrësi i propozuar pranon dhe pajtohet t'i nënshtrohet kushteve dhe rregullave të brendshme të SPN-së mbi administrimin e aplikacioneve për pjesëmarrje në skemë, pa marrë parasysh faktin se a do të bëhet apo jo pjesëmarrës.
4. Gjithë komunikimi, përfshirë këtu plotësimin e procesit, me pjesëmarrësin e propozuar në lidhje me rregullën duhet të bëhet me shkrim dhe t'i adresohet pjesëmarrësit të propozuar në adresën e dhënë më poshtë .
5. Pjesëmarrësi i propozuar pajtohet me publikimin e emrit dhe të dhënave të përgjithshme mbi aplikimin e tij për aderim në uebfaqen publike të SPN – BQK.
6. Pjesëmarrësi pajtohet të jetë pjesëmarrës në skemë si kreditor/iniciues. Pjesëmarrësi pajtohet dhe i pranon të gjitha rregullat dhe detyrimet që dalin nga kjo marrëveshje duke përfshirë edhe të gjitha dokumentet e tjera të cilat janë pjesë integrale e kësaj marrëveshje.
7. Kjo marrëveshje dhe të gjitha çështjet që dalin apo janë të lidhura me të i nënshtrohet rregullativës ligjore të aplikueshme në Kosovë.
8. Kësaj marrëveshje i bashkëngjitet informacionit siç vijon më poshtë:
  - a. Opinioni i këshilltarit juridik të brendshëm ose të jashtëm mbi kapacitetin dhe autoritetin në formën e përcaktuar nga SPN-ja, konfirmimi zyrtar juridik mbi kapacitetin e kreditorit për përmbushje të kërkesave dhe obligimeve nga kjo marrëveshje dhe të gjitha aktet e lidhura me të dhe skemën e DD në Kosovë.
  - b. Përgjigjet në pyetjet e dhëna në shtesën e kësaj marrëveshje.

## **PËR DHE NË EMËR TË PJESËMARRËSIT TË PROPOZUAR**

Nënshkruar nga  
(1)

-----

Emri /Pozita -----

Data e nënshkrimit-----

Vula

Nënshkruar nga  
(2)

-----

Emri /Pozita -----

Data e nënshkrimit -----

Vula

## SHTESA

- A. Pjesëmarrësi i propozuar duhet të sigurojë informacionin e kërkuar në këtë shtesë në mbështetje të aplikimit të tij për pjesëmarrje në skemë. Dështimi në ofrimin dhe/apo sigurimin e këtyre informacioneve mund të rezultojë me refuzimin e aplikacionit apo vonesa në procesimin e tij.

Informacioni i dhënë duhet të regjistrohet në regjistrin e pjesëmarrësve të skemës në SPN.

Pjesëmarrësi i propozuar e kupton dhe pranon se çdo informacion i dhënë në përgjigje të pyetjeve në këtë seksion/paragraf

- B. do të bëhet publik në uebfaqen publike të SPN-së dhe mund të bëhet i disponueshëm për shkarkim nga ana e SPN-së.

Emërtimi i plotë i pjesëmarrësit të propozuar	
Adresa zyrtare për komunikim	
Personi kontaktues dhe kontakt info 1*	
Personi kontaktues dhe kontakt info 2*	

Pjesëmarrësi i propozuar e kupton dhe pranon se çdo informacion i dhënë në përgjigje të pyetjeve në këtë seksion /paragraf

- C. do të jetë i disponueshëm vetëm për SPN-në dhe departamentet e tjera brenda BQK-së të cilat janë të autorizuara për këtë dhe nuk do t'i lihet në dispozicion asnjë trupi apo organi tjetër.

Të dhënat për kontakt ( për komunikim me SPN) një e-mail adresë e përgjithshme /zyrtare duhet të ofrohet p.sh. D@organizata.com

Të dhënat kontaktuese të individëve **nuk** duhet të ofrohen/jepen

Data e ardhshme e gatishmërisë ( kjo fushë duhet të plotësohet në rastet kur pjesëmarrësi i propozuar kërkon të specifikojë një datë për fillimin e operimit /pjesëmarrjes e cila është pas datës ), (shëno datën ).

Pjesëmarrësi i propozuar i cili do të fillojë operimet /pjesëmarrjen në skemë më (shëno datën) nuk kërkohet të plotësojë këtë fushë.

Aneks i Marrëveshjes mbi Pjesëmarrjen e Kreditorëve në Skemën e Debitimit Direkt në Kosovë

**Dedikimi i llogarisë së kreditorit për Debitim Direkt**

Në bazë të Marrëveshjes mbi Pjesëmarrjen e Kreditorëve në Skemën e Debitimit Direkt në Kosovë të nënshkruar nga ana e kreditorit \_\_\_\_\_, i njëjti deklaron se llogaria bankare nr. \_\_\_\_\_ Emërtimi i kreditorit

Llogaria 1:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Numri i llogarisë

\_\_\_\_\_ e hapur

Emërtimi i llogarisë

në \_\_\_\_\_

Emërtimi i bankës

është llogaria e vetme e dedikuar për veprimet lidhur me Skemën e Debitimit Direkt.

Llogaria 2: (Opcionale)

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Numri i llogarisë

\_\_\_\_\_ e hapur

Emërtimi i llogarisë

në \_\_\_\_\_

Emërtimi i bankës

Llogaritë e lartshënuara do të jenë llogaritë të cilat i bashkangjiten kodit të kreditorit të lëshuar nga BQK-j për veprimet e lidhura me transaksionet e Debitimit Direkt për \_\_\_\_\_

Shënim:Kreditori mund të operojë me dy llogari kolektuese për Debitim Direkt. Kreditori duhet të aplikojë në BQK për kodin e kreditorit lidhur me të dy llogaritë bankare.

Nënshkruar nga:

-----

Emri /Pozita -----

Data

Vula